

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtaret: Enver Peci, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPSHCRK), për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.321/2016 të datës 08.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.02.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e paditëses Komuna e Podujevës, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. 321/2016 të datës 08.11.2016 dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2152/14 datë 12 korrik 2016.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.321/2016 të datës 08.11.2016, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditëses Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2152/2014 datë 12 korrik 2016, është vërtetuar.

Paditësja kësaj gjykate në afat ligjor i ka parashtrua kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, me të cilën në tërësi e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozime që aktgjykimet e atakuara të gjykatave të instancave më të ulëta t'i prish dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në shkallën e parë.

Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimeve të atakuara, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë dhe shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kërkese është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës nr.02/318/2014 datë 19.09.2014, është aprovuar si e bazuar ankesa e parashtruar nga ankuesja H. B., pastaj është shfuqizuar vendimi nr.13-016-75289 i dt. 03.09.2014 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, si dhe vendimi i Udhëheqësit të Personelit, nr. 13-856 i dt. 03.03.2014, pastaj është obliguar Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Personelit që ta kthejnë nëpunësen civile H.B. në vendin dhe detyrat e punës sipas akt emërimit të dt. 29.02.2012, ndërsa përgjegjës për zbatimin e vendimit është caktuar Kryetari i të paditurës dhe Udhëheqësi i Personelit. Paditësi fillon konfliktin administrativ kundër aktvendimit të paditurës në të cilën gjykata e shkallës së parë e refuzon kërkesëpadinë si të pa bazë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë duke refuzuar ankesën e paditësit e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresat e lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar si të pa bazuar ankesën paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimet e atakuara nuk janë përfshi me shkelje të drejtës materiale siç pretendon paditësi në kërkesë.

Paditësja në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, potencon vetëm në mënyrë të përgjithshme shkeljet e së drejtës materiale duke konsideruar se aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të drejta nga fakti se transferimin e punëtores e bazojnë si pasojë e masës disiplinore për shkak të shkeljes së rëndë, fakt që sipas paditëses nuk qëndron por transferimi është bërë për shkakë nevojave të paditësit për kryerjen sa ma profesionale të punëve.

Pretendimet e më sipërme të paditëses sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndrojnë. Gjykatat e instancave më të ulëta bazën e vlerësimit të ligjshmërisë së transferimit të nëpunëses civile H. B., pikërisht e bazojnë në vendimin nr.13-856 datë 03.03.2014, të zyrës së personelit të paditëses, pastaj vendimit nr.13-016-75289 i dt. 03.09.2014 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të paditëses, që njëherit edhe ka qene objekt i kësaj çështjeje administrative dhe më të drejt vendimi i të paditurës nr.02/318/2014 datë 19.09.2014, si dhe aktgjykimet e atakuara, bazohen në nenin 8 të Rregullores nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, e cila përcakton kushtet që duhen të plotësohen për transferimin e nëpunësve civil. Kësisoj, duhet kumulativisht të plotësohen këto kushte: pajtimi me eprorin e drejtpërdrejt, miratimi i udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit si dhe pëlqimin e nëpunësit civil. Gjykatat e instancave më të ulëta në aktgjykimet e atakuara me të drejt kanë vërtetuar se, përveç vendimit të udhëheqësit të personelit për transferim te nëpunëses civile H. B., ka munguar proceduralisht miratimi i udhëheqësit më të larte administrativ, në rastin konkret Kryetarit të Komunës së paditëses, si dhe pëlqimi i nëpunëses civile në fjalë.

Gjykata Supreme bazuar në dispozitën e nenit 53 te LKA-ës, duke shqyrtuar aktgjykimet e kundërshtuar brenda kufijve të kërkesës, konstaton se janë të pabazuara thëniet në kërkesë përkitazi me shkeljet e drejtës materiale nga se aktgjykimet përmbajnë arsyera të mjaftueshme dhe janë vlerësuar të gjitha faktet në këtë çështje juridike, gjykatat instancës më të ulët drejt kane zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se padia e paditëses është e pa bazuar.

Nga si u tha më sipër, në baze të nenit 54 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Më 22 shkurt 2017, ARJ.nr.44/2016

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Enver Peci